

Mark Krasniqi

BIBLIOTEKA
SHTETIT


8JH-1

k 95

JEHONA
E KOHES
poezi

8117-1
K 95

Mark
Krasniqi



JEHONA
E KOHËS

poezi
nga Kosova

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

VARGJET E MIA

Vargjet e mia s'janë shpend krahlehtë,
që lart flutron n'hapësirë të qiellit;
ato nuk janë as hënë e zbehtë,
as janë shkëlqim i rrezes së diellit.

Vargjet e mia kanë mbirë n'këtë tokë —
me bar e hithra, me lule e ferra;
ato jehojnë si përroi n'bokë,
si ftoit të vjeshtës iu vjen era.

Kënga ime s'është zanë nga përralla,
as fjalë e modës, as det pa fund;
ajo s'këndon punë të mëdha e të rralla,
por njerëz të thjeshtë që veshin zhgun.

MULLIRI I FSHATIT

Ti n'skaj të fshatit strukur,
mbi jaz të kthjellët si loti,
në fëmijëri gjithmonë m'je dukur
një përrallë e treguar moti.

Kënga e çakallës sate
sa herë m'ka vënë në gjumë,
n'jaz tënd ti gjithmonë pate
për mua gëzime shumë.

Sa herë që babai çonte
plot thasët drithë n'mulli
kjo mua tepër m'gëzonte,
se m'merrte mbi thasë pranë tij.

Dhe ndërsa mullisi i vjetër
i vinte thasët n'kandar,
unë këtu pashë një botë tjetër
që kurrë s'e kisha parë:

Një gur sa lëmshi i diellit
vetë sillej — pa prekur me dorë,
nën të shllungat e miellit
hidheshin si t'reshte dëborë.

Kënga e mullirit t'fshatit
dhe sot n'shpirt tim është gjallë,
dhe jazi që rrëshqet rrëzë shpatit
n'zemër m'pëshpërit me mall.

J A Z I

Jazi i fshatit që rrjedh n'mulli
qetas kalonte pranë shtëpisë së vjetër;
verës për mua, kur isha fëmijë,
si jazi s'kishte asnjë gëzim tjetër.

Uji i kthjellët porsi bilur
këndshëm gumëzhonte si bleta në bli;
n'fund t'jazit shtrihej shumë rërë e gurë,
flutrat krahëshkruar bridhnin përmbi.

Ktheja në mbrëmje në shtëpi me pata,
bija n'shtrat drrasash t'shtruar me fier,
koteshin shpejt sytë, pa përralla t'gjata,
sa m'thonte nëna «natën e mirë».

Babai i brengosur shikonte rërët:
— Ah, sikur sonte t'binde pak shi,

na mbet pavada* fare e shkretë,
as gjysma e misrit ende s'ka mbi. —

Unë n'shtrat përshpëritja tjetër dëshirë;
që edhe nesër t'jetë ditë plot diell;
unë qysh atëherë e dija mirë
se babai magjen s'e lë pa miell.

Një natë unë ëndërr kështu kam parë:
disi tërë qielli kish rënë n'jaz brënda
dhe ishte mbushur flori e arë, —
laheshin natën yzët e hëna...

Të nesërmen shumë kohë me shokë kërkova
nëpër rërë t'jazit poshtë e përperjetë;
sa e sa gurëz n'ujë rrotullova
një yll t'pruar këtu për ta gjetë...

*) pavada — arë (fushë) që nuk mund të ujitet.

ÇIFTELIA

Dhomën e miqve në katin e dytë
të kullës së vjetër të babait tim,
edhe sot shpesh ma shohin sytë —
me oxhak zjarri, me prush e tym.

N'mur llampa e vogël në një gozhdë varë,
cerga e shtruar, jastëkë përbri,
n'oxhak vlon xhezvja, n'fund një tangar,
pranë tij ngroheshim ne, shtatë—tetë fëmijë.

N'gozhdë çiftelia zwarej bishtgjatë,
pranë saj lahuta dhe një kavall;
dimrit pas darke, gati çdo natë,
mblidheshin fqinjët për t'qarë pak hall.

Shpeshherë xhaxhai me çifteli,
në ballë t'oxhakut, mbështetur për mur,

luante gishtrinjte me shumë mjeshtëri,
nga zemra hiqte të rëndë një gur.

Diku n'fund t'dhomës, me vëllezërit e tjerë,
dëgjoja këngën, as frymë pa marrë,
q'e këndonte plaku me një zë të çjerrë,
për luftë, përleshje, për gjak e varrë.

Dridheshin telat si krahët e bletës,
jehonte kënga si lumi në bokë,
për trimëri të Shotës e t'Azem Bejtës —
më bëhej se koka më mbetej pa flokë...

Kjo çifteli me tela të hollë,
dhe këngët e trimërisë n'kullën e vjetër,
për mua ishin e para shkollë,
që nga kujtimi nuk u zbe tjetër.

Sa herë që ditën hyja vetë n'dhomë
shikoja gjatë atë çifteli,
pyetja vetveten, si fëmi i njomë:
ku mëshihen këngët me aq trimëri!

Më vonë dëgjova nëpër Evropë,
n'opera t'famshme, muzikë hyjnore,
por n'zemrën time, si thellë në një gropë,
dy tela dridhen edhe sot prore...

D J E P I

Si lundër e çarë e lënë në harresë
në limanin e fatit, në prehër të vetmisë –
pushon mbi tra, nën pullaz të vjetër,
djepi i fëmijërisë.

Gjashtë vëllezër e një motër
në këtë djep i rriti kënga e nënës.
Që të gjithë në këtë vatër
shijuan gëzimet e para:
rrezen e diellit, hijen e hënës,
erën e mollës në behçe të bleruar,
këngën e bilbilit në magjë te ara.

Tani nën rrjetën e marimangës,
në djepin e shkretë, pushojnë kujtimet:
dora e nënës, që gjatë shtatë verash
këtë djep përkundi
si puhia e mbrëmjes degëzën e qershisë,